

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ /06/2025

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: “Pajisje primare, sekondare dhe pajisje ndihmëse për N.Stacione dhe Linjat TL”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Transformatorë 31170000-8. Transformatorë tensioni 31172000-2, Kabllo të tensionit të lartë 31321300-5, Panele centralesh 32542000-4.

Vlera e fondit limit: 199,831,677 (Njëqindë e nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëqindë e tridhjetë e një presje gjashtëqindë e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose (2,032,462.13 (Two million thirty-two thousand four hundred sixty-two piont thirteen EUROS) euro excluding VAT) euro pa TVSH. Kursi kembimit sipas Bankës së Shqipërisë i datës 19.06.2025 është 98.32 (nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e dy).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt: “**Pajisje primare, sekondare dhe pajisje ndihmëse për N.Stacione dhe Linjat TL**”, ka për qëllim furnizimin e Autoritetit Kontraktor me disa pajisje të cilat përdoren për mirëmbajtjen e Nënstacioneve dhe linjave 35 kV, në funksion të veprimtarisë së punës së AK.

Referuar procedurës së prokurimit, AK vlereson se kjo procedure prokurimi nuk mund të ndahet në Lote, pasi për arsye të tipologjisë së materialeve si nga pikepamja e funksionimit dhe instalimit të tyre, kanë një natyrë integruese në raport me njëra tjetren ashtu edhe me N/stacionin elektrik ku do instalohen. Krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa Operatore Ekonomik mund të sjellë përdorshmeri të perkohshme ose vonesa të shumta në funksionimin e pajisjeve dhe materialeve të cilat mund të furnizohen nga një tjetër Operator Ekonomik, kontraktor i një loti tjetër.

AK nuk mund të disponojë një element nga mallrat objekt prokurimi në vetë dhe të presë furnizimin e mallrave të tjera, në qoftë se këto janë të ndara në lote.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Gjithashtu, vonesat qe mund te shkaktohen nga marredhenia e me disa operatore ekonomike mund te veshtiresoje edhe nevojat e AK per ushtrimin e funksionit te saj, dhe mund te krijohen probleme me furnizimin e mallrave.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtorja e Tensionit të Lartë OSSH sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023,2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023,2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2025), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar për të gjithë mallrat objekt prokurimi kjo e vërtetuar nepermjet dokumentave origjinal ose noterizuar si perfaqesues i kompanisë prodhuese për të gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizimi distributori, OE duhet të paraqesë dokumentacionin, që vërteton se OE në fjale është perfaqesuesi zyrtar për Republikën e Shqipërisë. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si, numri i telefonit, faksi, posta elektronike dhe faqja e internetit, të dhëna të nevojshme për autoritetin kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi ka të bëjë me informacion të nevojshëm se ku prodhohet malli dhe mundësia reale për të bërë furnizimin, nepermjet autorizimit që i jepet operatorit ekonomik ofertues

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë broshurë/katalog/manual përdorimi nga kompania prodhuese për të gjitha mallrat objekt prokurimi, ku të vërtetohet përputhja e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

eshte gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi katalogu i mallit tregon karakteristikat teknike te produkteve, me qellim permbushjeje e te gjitha kerkesave dhe specifikimeve teknike .

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat te cilat verifikojne qe releja e mbrojtjes dhe kontrollit eshte ne perputhje me te gjitha standardet EN 60255-26:2013, EN 60255-27:2014, IEC 62439-3:2016 për protokollet PPR dhe HSR, IEC 61850-6,7-1 ,7-2,7-3,7-4,8-1 niveli A, standardi IEEE C37.238TM02017 dhe DNP 3.0 ose ekuivalente me to. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë *SSH IEC SSH EN*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese raportet e testimit qe verifikojne qe releja e mbrojtjes dhe e kontrollit eshte ne perputhje me te gjitha standardet EMC dhe LVD, direktivat EMC 2014/30/EU, Direktiva e Tensionit të Ulët 2014/35/EU, EN 60255-26: 2013, CISPR 11: 2015, CISPR 22:2008, EN 60255-27:2014, IEC 62439-3:2016 dhe IEEE 802.1D për protokollet PPR dhe HSR, IEC 61850-4,6,7-1,7-2,7-3,7-4 ,8-1,10, standardi IEEE C37.238TM-2017 dhe DNP 3.0 ose ekuivalente me to. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë *SSH IEC SSH EN*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese per panelet e mbrojtje-komandimit certifikatat dhe raportet e testimit, te cilat vertetojne se, produkti eshte ne perputhje me standardet EN 61439-2:2011, EN 61000-6-2:2005, EN61000-6-4:2007+A1:2011 ose ekuivalente me to, si edhe raportet e testimit qe paneli ka nje shkalle mbrojtjeje IP42 ose me te mire se ajo. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë *SSH IEC SSH EN*.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat dhe raportet e testimit, të cilat verifikojnë që blloku i testimit është në përputhje me standardin EN 60947-7-1:2009 ose ekuivalent me të. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë *SSH IEC SSH EN*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat, që vertetojnë se matesi i energjise është në përputhje me standarde EN 61000-6-3:2007, EN 61000-6-1:2007, EN 61000-3-2:2006 and EN 61000-3-3:2005 ose ekuivalent me to. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë *SSH IEC SSH EN*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.9 Operatori ekonomike ofertues duhet të paraqesë certifikate CE/SSH IEC SSH EN dhe raport testimi të kabllos që ofron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat, të cilat vërtetojnë se sinjalizuesit e alarmeve janë në përputhje me standardet EN 61623-1, EN 61000-4/2-6, EN 55011:2007 ose ekuivalent me to. AK do pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardit evropian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë *SSH IEC SSH EN*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Manualin e përdorimit të radrizzatoreve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi kjo ka të bëjë me mënyrën e maksimizimit të përdorimit dhe jetgjatësisë së produktit që furnizohet, duke garantuar Autoritetin kontraktor për mallin që furnizohet.

2.3.12 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë Certifikatat *CE/SSH IEC SSH EN per radrizzatorin e ofruar*.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi kjo certifikatë ka të bëjë me cilësinë e produktit që furnizohet, duke garantuar Autoritetin kontraktor për mallin që furnizohet.

2.3.13 Operatori duhet të paraqesë raportet e testimit të prodhuesit/distributorit për radrizzatoret.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40 pika 6 gërma (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në përmbushje të kriterit

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

të mësipërm Operatorët Ekonomike, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të ngjashme për ti krijuar bindjen AK se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të paraqese Diagramat njepolare te radrizatoreve te ofruar.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi keto diagrama ndihmojnë autoritetin për menyren e lidhjes se radrizatoreve dhe elementeve te tyre.

2.3.15 Operatori ekonomik duhet të paraqese tabelen teknike qe gjendet ne specifikimet teknike te radrizatoreve, te plotesuar dhe firmosur nga prodhuesi.

2.3.16 Operatori ekonomik duhet të paraqese Deklarate garancie 2 vjecare nga prodhuesit e baterive dhe radrizatoreve.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi garancia e mallrave jep siguri për furnizime cilësore dhe e ben operatorin ekonomik fitues me te pergjegjshem per produktet qe oferton.

2.3.17 Operatori ekonomik, ditën e hapjes së ofertave në Drejtorinë e Tensionit të Lartë duhet të paraqese një mostër për artikujt e mëposhtem:

- Rele digjitale mbrojtje komandim për transformator fuqie me 3 peshtjella 48-250VDC/AC.
- Pajisje primare për eliminimin e ferrerezonancës në transformatorët e tensionit
- Stivues elektrik profesional 1.5 ton
- Transpaletë e thjeshtë 2.5 ton

Argumentim: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me specifikimet teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me pikën 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. bazuar në Udhëzimin Nr. 2 datë 02.05.2019. Faza e paraqitjes së mostrave i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ana jonë. Gjithashtu ky kriter

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

gjen mbeshtetje ne piken 6 te nenit 40 te të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

2.3.17 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate, ku deklaron se te gjithë produktet jane te rinj (te paperdorur).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizimin me mallra të reja.

Gjithashtu me levrimin e mallit, furnizuesi i mundshem duhet te paraqese per materialet :

a. *Autorizim prodhuesi ose distributori.*

b. *Certificate Garancie, minimum 24 (njëzet e katër) muaj nga levrimi i mallit.*

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të brendshme DTL/ Grup pune pranë Autoritetit Kontraktor Përfitues DTL, për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, përllogaritje fondi dhe kriteret të vecanta kualifikuese në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.